

REAGIM I KËSHILLIT PËR MBROJTJEN E TË DREJTAVE DHE LIRIVE TË NJERIUT (KMDLNJ)

DHUNIM I TË DREJTAVE TË NJERIUT NË BURGUN E HAGËS

FAQE 4-5



“KMDLNj ishte informuar se oficerë të burgut nuk kanë sjellje të mira me të paraburgosurit në ndërkohë që njëfarë John dallohej për arrogancën dhe kërcënimin ndaj pengjeve të Hagës. Për atë fillimisht roje pastaj mbikëqyrës u mor vesh identiteti vetëm kur u paraqit si prokuror i Zyrës së Prokurorisë Speciale pranë Gjykatës Speciale Raciste në Hagë. KMDLNj e stërpërsërit reagimin dhe ngre shqetësimin për ata që kanë sy dhe veshë në Kosovë për

shkelje brutale të të drejtave të njeriut të pengjeve të Hagës, të gjithë shqiptarë dhe të gjithë shtetas të Kosovës!”, është theksuar në reagimin e Këshillit për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive të Njeriut (KMDLNj)

RAMA I DREJTOHET KUSHTETUESËS PËR BUXHETIN E PRISHTINËS

F. 7



NGËRÇI NË KUVEND: KUR POLITIKA NDESHET ME KUSHTETUTËN

F. 3



AKTUALE

KUSHTETUESJA VENDOS MASË TË PËRKOSSHME QË NDALON ÇDO VEPRIM TË KUVENDIT DERI MË 30 SHTATOR

F. 3

TRUMPI I BËN PRESION EVROPËS PËR NAFTËN RUSE

F. 2

A U CENUA SIGURIA E KOSOVËS NGA ÇIFTI I DYSHUAR PËR SPIUNAZH?

F. 2

NË PRAG TË 26-VJETORIT TË POLICISË SË KOSOVËS MBAHEN AKTIVITETE NË SHESHIN “ZAHIR PAJAZITI”

F. 6

EKONOMI



TRI KOMPANI TË REJA LICENCOHEN PËR FURNIZIM ME ENERGJI ELEKTRIKE

F. 8

ATK-JA SHËNON RITJE TË QËNDRUESHME TË TË HYRAVE NË PERIUHDHËN JANAR - GUSHT

F. 8

SPORT



KOSOVA PËSON HUMBJE TË THELLË NGA ZVICRA

F. 10

RENOVA

PUTZ

Maqedoni
Xhepçisht –Tetovë
Gurëz-Ferizaj

Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289

E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA

GROUP SH.PK.

NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE

INFO: 049-111-101,
044-511-177

www.princesha-ks.com

Bunjamini

FABRIKA E LLAQEVE

044/256-051
044/367-061
028/532-617

MITROVICË

STYROKOL · BUNJAKOL · CUROFASADË

Kolegji BIZNESI

www.kolegjbiznesi.com

info@kolegjbiznesi.com

030 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878



SIGMA

VIENNA INSURANCE GROUP

SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË

Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY

Digital Agency

Endrit Shaqiri
+38344685122

Internet Website,
Marketing...

TRUMPI I BËN PRESION EVROPËS PËR NAFTËN RUSE

UASHINGTON, 5 SHTATOR - Presidenti amerikan, Donald Trump, duket se mori një qëndrim më të ashpër me mbështetësit kryesorë evropianë të Kievit, duke u thënë atyre se duhet t'i bëjnë më shumë presion financiar Rusisë dhe aleates së saj kryesore, Kinës, për ta detyruar Kremlinin që t'i japë fund luftës në Ukrainë, tha një zyrtar i Shtëpisë së Bardhë. Udhëheqësit evropianë e ftuan "presidentin Trump në takimin e Koalicionit të Vullnetit", tha një zyrtar i Shtëpisë së Bardhë lidhur me telefonatën e zhvilluar më 4 shtator, pas takimit në Paris që zhvilluan mbështetësit e Kievit. "Presidenti Trump theksoi se Evropa duhet të ndalë blerjen e naftës ruse që po financon luftën - pasi Rusia mori 1.1 miliard euro nga shitjet e karburanteve për Bashkimin Evropian brenda një viti", tha zyrtari, sipas Reuters. Zyrtari i Shtëpisë së Bardhë shtoi se Trump gjithashtu tha

gjatë bisedës telefonike se "udhëheqësit evropianë duhet të ushtrojnë presion ekonomik mbi Kinën për financimin e përpjekjeve të luftës të Rusisë". Trump, i cili foli me udhëheqësit evropianë pas mbledhjes në Paris, nuk komentoi drejtpërdrejt për takimin në Paris. Por, në deklaratimet e mëvonshme për gazetarë, ai tha se "po, do ta bëja", kur u pyet nëse planifikonte të fliste me presidentin rus, Vladimir Putin, në të ardhmen e afërt. Evropa, që nga nisja e pushtimit rus të Ukrainës më 2022, ka tentuar të ulë varësinë që ka nga Rusia sa i përket furnizimeve me energji. Komisioni Evropian ka propozuar legjislacion për të hequr gradualisht importet e naftës dhe gazit rus nga BE deri më 1 janar 2028. Hungaria dhe Sllovakia, shtete që udhëhiqen nga liderë nacionalistë që kanë lidhje të ngushta me Kremlinin, kanë vazhduar të importojnë



produkte energjetike ruse, pavarësisht përpjekjeve të BE-së për diversifikim. Deklaratat e Shtëpisë së Bardhë erdhën pas presidentit francez, Emmanuel Macron, - një nga udhëheqësit e Koalicionit të Vullnetit, së bashku me kryeministrin britanik, Keir Starmer - tha se 26 vende ishin pajtuar që të merrnin pjesë në garancitë e sigurisë që do t'i ofroheshin Ukrainës pas përfundimit të luftës, duke shtuar se mbështetja e ShBA-së për këtë plan do të finalizohet

në ditët në vijim. Udhëheqës nga rreth 30 aleatë perëndimorë të Ukrainës u takuan me presidentin ukrainas, Volodymyr Zelensky, për të diskutuar garancitë për vendin e shkatërruar nga lufta, pas një marrëveshjeje të mundshme paqeje me Rusinë që do t'i jepte fund konfliktit më të madh dhe më vdekjeprurës në Evropë që nga Lufta e Dytë Botërore. Macron shtoi se disa vende të këtij koalicioni ende po finalizojnë planet e tyre.

Koalicioni, që iu bashkua bisedimeve në Paris, përfshiu rreth 30 shtete që mbështesin Ukrainën, kryesisht nga Evropa. Por, në takim ishin edhe Kanadaja, Australia dhe Japonia. Macron tha se 26 vende "janë zotuar të dislokojnë trupa si forcë e sigurisë për Ukrainën, ose të jenë të pranishëm në tokë, det ose ajër". Ai shtoi se forcat nuk do të vendoseshin në vijën e frontit, por në zona të tjera, për të cilat ende nuk është vendosur. "Në ditët në vijim, ne do të finalizojmë mbështetjen amerikane për këto garanci sigurie. Shtetet e Bashkuara, siç thashë, kanë qenë të përfshira në të gjitha fazat e procesit", tha udhëheqësi francez. ShBA-ja ende nuk ka dhënë ndonjë zotim për një rol të qartë të saj pas luftës, me Putinin që ka paralajmëruar se Moska është e gatshme "t'i zgjidhë të gjitha detyrat tona ushtarakisht" nëse nuk arrihet një marrëveshje e pranueshme e paqes.

MACRON: DO TË DAKORDOHEMI ME SHBA-NË NË DITËT NË VIJIM PËR GARANCITË E SIGURISË PËR UKRAINËN

PARIS, 5 SHTATOR - Presidenti i Francës, Emmanuel Macron, ka thënë se 26 vende janë pajtuar të marrin pjesë në garancitë e sigurisë për Ukrainën pas përfundimit të luftës, dhe se mbështetja e ShBA-së për këto garanci do të finalizohet në ditët e ardhshme. Macroni foli pasi priti një ditë diplomacie hibride në Pallatin Elize në Paris të enjten. Rreth 30 udhëheqës të aleatëve perëndimorë të Ukrainës u takuan me presidentin Volodymyr Zelensky për të biseduar për garancitë e sigurisë për vendin e shkatërruar nga lufta, të cilat do ta pasonin çdo marrëveshje për paqe të arritur



me Rusinë për t'i dhënë fund konfliktit më të madh dhe më vdekjeprurës në Evropë që nga Lufta e Dytë Botërore. Bisedimet u pasuan nga një videokonferencë me presidentin e Shteteve të Bashkuara të

Amerikës, Donald Trump. Macroni tha se 26 vende "janë zotuar se do të dërgojnë trupa si forcë sigurie në Ukrainë ose do të jenë të pranishme në tokë, në det ose në ajër". Ai theksoi se këto forca nuk do të

vendosen në vijën e frontit, por në zona që ende nuk janë përcaktuar. "Në ditët e ardhshme do ta finalizojmë mbështetjen amerikane për këto garanci sigurie. Shtetet e Bashkuara, siç thashë, kanë qenë të përfshira në të gjitha fazat e këtij procesi", tregoi Macron. ShBA-ja ende nuk ka premtuar rol të qartë në Ukrainë pas luftës. Pjesëmarrja e saj shihet si thelbësore për t'i mbështetur përpjekjet e aleatëve. Zelensky, në një konferencë të përbashkët me Macronin, tha se sapo një dokument paraprak të miratohet nga ShBA-ja, do të ndërmerren hapa të tjerë. "Është e rëndësishme që Shtetet e

Bashkuara janë me ne. Sot biseduam me presidentin Trump. Shumë faleminderit për angazhimin e tij", tha Zelensky. Të dy liderët folën gjithashtu për përpjekjet për të siguruar një takim mes Zelenskyt dhe presidentit të Rusisë, Vladimir Putin. "Nëse Rusia vazhdon të mos pranojë bisedime konkrete për paqe... ne do të vendosim sanksione shtesë në bashkëpunim me Shtetet e Bashkuara të Amerikës", tha Macron. "Këtë e shprehu edhe presidenti Trump më herët gjatë bisedës", zbuloi ai. Përpjekjet për ta bërë të mundur këtë takim mes tyre janë penguar vazhdimisht nga Moska.

Raportohet për 19 të vrarë nga sulmet izraelite në Gazë

GAZA, 5 SHTATOR - Agjencia për mbrojtje civile në Gazë raportoi se 19 persona janë vrarë më 5 shtator si pasojë e një sërë sulmesh ajrore izraelite në dhe përreth Qytetit të Gazës - vendbanim që ushtria izraelite dëshiron ta marrë nën kontroll të plotë. Zëdhënësi i kësaj agjencie, Mahmud Bassal, tha se sulmet goditën ndërtesa dhe

tenda ku strehohen palestinezët e zhvendosur në disa lagje dhe në periferi të qytetit, ku Kombet e Bashkuara thonë se më shumë se një milion persona po përballen me zi të bukës. Izraeli ka intensifikuar bombardimet ndaj Qytetit të Gazës që kur ka deklaruar se do të nisë një ofensivë për ta marrë nën kontroll të plotë. Zëdhënësi i ushtrisë izraelite,



Nadav Shoshani, deklaroi një ditë më parë se nuk do të ketë njoftim për nisjen e ofensivës për shkak të "ruajtjes së

elementit të befasisë". Ndërkaq, një zëdhënës tjetër ka thënë se Izraeli veçse kontrollon 40 për qind të qytetit. Izraeli pret që ofensiva e re të detyrojë rreth një milion persona të zhvendosen drejt jugut të Rripit të Gazës. Lufta në Gazë nisi më 7 tetor 2023 pasi Hamasi - grupi palestinez i shpallur organizatë terroriste nga

Shtetet e Bashkuara dhe Bashkimi Evropian - sulmoi jugun e Izraelit, duke vrarë afër 1.200 persona dhe duke rrëmbyer 251 të tjerë. Si pasojë e ofensivës izraelite, në Gazë janë vrarë më shumë se 64.000 palestinezë sipas shifrave të prezantuara nga Ministria e Shëndetësisë që udhëhiqet nga Hamasi - shifra që nga OKB-ja vlerësohen të besueshme.

A U CENUA SIGURIA E KOSOVËS NGA ÇIFTI I DYSHUAR PËR SPIUNAZH?

Një oficer ushtarak kroat dhe partnerja e tij serbe u arrestuan së voni në Kroaci, nën akuzat për spiunazh për Serbinë. Në Kosovë, ku ata dyshohet se kryen këtë veprimtari, konsiderojnë se ky rast vë në pah përpjekjet e Beogradit për të depërtuar në strukturat e ndjeshme të Prishtinës, por edhe të NATO-s. A u rrezikua siguria kombëtare e Kosovës?

PRISHTINË, 5 SHTATOR - Rasti i arrestimit të dy personave në Kroaci mbi dyshimet për spiunazh për Serbinë, i bërë i njohur në fund të gushtit, vazhdon të jetë plot me të panjohura, ashtu sikurse veprimtaria të cilën ata akuzohen ta kenë kryer në Kosovë. Një pilot kroat, i identifikuar si J.I., i cili u tha se ka shërbyer në misionin paqeruajtës të Organizatës së Traktatit të Atlantikut Verior (NATO) në Kosovë - KFOR, dyshohet se ka zbuluar tek e dashura e tij, A.M., serbe nga Mitrovica e Veriut, informacione të ndjeshme, të cilat, më pas, ajo thuhet se ia ka përcjellë partisë kryesore të serbëve në Kosovë. (Lista Serbe, e cila gëzon mbështetjen e Beogradit zyrtar, ka mohuar se e njëjti dyshuarën për spiunazh). Media kroate, Slobodna Dalmacija raportoi se hetuesit, mbi bazën e një urdhri gjyqësor, kanë kontrolluar pajisjet e tyre mobile dhe komunikimet, ku kanë gjetur mesazhe komprometuese që i kanë shtyrë të dyshojnë për spiunazh ndërkombëtar. Që të dyve u është caktuar masa e paraburgimit, por i gjithë hetimi mbetet i fshehtë, me qëllim që, siç kanë argumentuar autoritetet kroate, të mos dëmtohet procesi. Në Kosovë, rasti ngriti një pyetje të rëndësishme: a u rrezikua siguria kombëtare e vendit? Ministria e Punëve të Brendshme e Kosovës nuk i është përgjigjur pyetjeve të “Radios Evropa e Lirë” lidhur me ndikimin e mundshëm të këtij rasti në sigurinë e

brendshme.

Për Jeta Loshajn, hulumtuese në Qendrën Kosovare për Studime të Sigurisë (QKSS), ky rast i dyshuar, të cilin ajo e konsideron serioz, nuk ka paraqitur rrezik të drejtpërdrejtë për sigurinë, pasi argumenton se nuk ka informacione se “janë komprometuar informacione kritike mbi Kosovën apo Forcën e Sigurisë së Kosovës”. “Por, në plan më të gjerë, siguria kombëtare e Kosovës është cenuar nga fakti që shërbimet serbe, në bashkëpunim me ato ruse, po vazhdojnë të tentojnë të depërtojnë në struktura të ndjeshme, dhe të testojnë rezistencën e sistemeve të sigurisë”, thotë ajo për “Radion Evropa e Lirë”.

Ndërkaq, eksperti i sigurisë, Burim Ramadani, vlerëson se rastet e spiunazhit nga shtete armiqësore janë të komplikuara, dhe mund ta rrezikojnë sigurinë kombëtare. Rasti i fundit “është dëshmi që Kosova vazhdimisht përballet me luftë të ashpër, agresive, përmes inteligjencës armiqësore serbe, ruse e të tjera”, thotë ai për “Radion Evropa e Lirë”, duke theksuar se rastet e spiunazhit mund të marrin disa vite kohë për t’u zgjidhur.

“Luftë e hapur spiunazhi me NATO-n”

Ramadani dhe Loshaj e shohin këtë rast të dyshuar si një përpjekje më të gjerë të Serbisë për të depërtuar në sistemet e sigurisë së Kosovës, i cili tregon edhe qasjen, sipas tyre,



armiqësore të Beogradit ndaj NATO-s, ku Serbia nuk është anëtare, por bën pjesë në Programin e saj të Partneritetit për Paqe. “Në aspektin e sigurisë rajonale dhe ndërkombëtare, ky është një prej rasteve që e dëshmon që shteti armiqësor, Serbia, jo vetëm që është jobashkëpunues dhe ka ambicie armiqësore ndaj shteteve të tjera, por tenton që në mënyrë armiqësore të përdorë asetet ose instrumente të shteteve të NATO-s, dhe kjo është luftë e hapur spiunazhi, që Serbia e bën edhe me NATO-n, jo vetëm me Kosovën”, thotë Ramadani. Një shqetësim që ngre Loshaj është se informacionet që mund të jenë mbledhur, si për bashkëpunimin e Kosovës me NATO-n, ashtu edhe për vetë trupat e aleancës, mund të jenë transferuar edhe në Rusi - “që i bie se kjo situatë mund të lidhet edhe me rivalitetet gjeopolitike që i shohim tani”, thotë ajo. Sipas saj, ky duhet të jetë alarm se sistemet e sigurisë nuk kufizohen vetëm në nivel bilateral, por kanë dimensione më të gjera. “Është pjesë e një përpjekjeje më të gjerë të Serbisë për të testuar rezistencën e NATO-s dhe për të identifikuar dobësi në

arkitekturën e sigurisë euroatlantike”, thotë ajo. Dy njohësit e sigurisë e shohin si sukses ndaljen e të dyshuarve, teksa Ramadani thotë se, përtej individëve, vlera e operacionit kroat mbetet te “shkatërrimi i operacioneve armiqësore”. Megjithatë, Loshaj thotë se ky rast i dyshuar i spiunazhit nxori në pah se ka boshllëqe të sigurisë, “sikurse dobësia e koordinimit më të thellë mes NATO-s, Kroacisë dhe Kosovës, për të adresuar operacionet e Serbisë”.

Çfarë thanë autoritetet?

Autoritetet kroate, të cilat e zbuluan rastin, kanë dhënë pak detaje për të. Ministri i Mbrojtjes, Ivan Anushiq, tha më 2 shtator se reputacioni i ushtrisë kroate është dëmtuar, por jo edhe siguria kombëtare. “Ai [piloti i arrestuar] nuk kishte atë nivel të lejes së sigurisë që t’i mundësonte të kishte të gjitha informacionet që i duheshin, të cilat mund të rrezikonin sigurinë dhe aftësinë e Forcave të Armatosura të Kroacisë”, deklaroi ai. Kosova është shprehur e gatshme të bashkëpunojë me Kroacinë, teksa Prokuroria Speciale i është drejtuar me shkresë autoriteteve

të Zagrebit për të siguruar prova për shtetasen e Kosovës, A.M. Nga MPB-ja nuk i janë përgjigjur pyetjes së “REL”-it nëse Kroacia ka kërkuar bashkëpunim. Ramadani thotë se Kosova duhet të kërkojë ekstradimin e A.M. në Kosovë, në mënyrë që ajo të përballet me drejtësinë, në vendin ku dyshohet se ka kryer veprimtarinë e spiunazhit. Ndërkaq, pas zbulimit të rastit nga mediat kroate, Policia e Kosovës bastisisthtëpinë e saj në Mitrovicë të Veriut, dhe aty gjeti “spreh, disa gëzhoja dhe fishekë”. A.M. raportohet se në të kaluarën ka punuar në misionin e Bashkimit Evropian për Sundim të Ligjit në Kosovë (EULEX). Mediat kroate kanë raportuar, duke u thirrur në burime, se ajo për tri vjet kishte grumbulluar dhe transferuar, përmes platformave të enkriptuara, të dhëna te Lista Serbe për lëvizjen e pjesëtarëve të KFOR-it dhe të serbëve në veri. NATO-ja i ka thënë “Radios Evropa e Lirë” se “i merr me seriozitet” këto akuza, duke shtuar se e ka parësore sigurinë e personelit dhe të misionit të saj në Kosovë dhe “integritetin e informacionit të klasifikuar”. Në KFOR, nga afër 4.800 pjesëtarë, 152 nga ta janë nga Kroacia.

KUSHTETUESJA VENDOS MASË TË PËRKOHSHME QË NDALON ÇDO VEPRIM TË KUVENDIT DERI MË 30 SHTATOR

PRISHTINË, 5 GUSHT - Gjykata Kushtetuese e Kosovës njëzëri ka vendosur masë të përkohshme përmes së cilës ua ndalon deputetëve të ndërmarrin veprime si dhe ndalon zhvillimin e ndonjë procedure për formimin e Qeverisë së re të Kosovës. Masa do të jetë në fuqi nga 5 shtatori deri më 30 shtator. Kjo masë u vendos nga Gjykata në mënyrë ex officio dhe në bazë të kërkesës së deputetëve të Listës Serbe. Kushtetuesja ka bërë me dije se ka pranuar kërkesën për masë të përkohshme, sepse ajo i shërben “evitimit të rreziqeve ose dëmeve të pariparueshme” dhe është në

“interes publik”.

Nëntë deputetët e Listës Serbe dhe deputeti goran, Adem Hoxha i janë drejtuar n Kushtetueses me kërkesë më 30 gusht, lidhur me votimin për nënkryetarin serb në Kuvendin e Kosovës. Gjykata ka theksuar se pa u vlerësuar dyshimet e ngritura nga Lista Serbe për shkelje kushtetuese në seancat e 26 dhe 28 gushtit “është e domosdoshme që të ndalohen të gjitha veprimet e mëtejme drejt zgjedhjes së qeverisë dhe vazhdimi të punës së Kuvendit”. Kushtetuesja ka theksuar se masën e përkohshme ka venduar “në mënyrë që të



mos cenohet rendi juridik dhe demokratik në Republikën e Kosovës”. Ankesa e Listës Serbe, ka ardhur pasi kryetari i ri i Kuvendit, Dimal Basha, i ka hedhur në votim ndaras kandidatët për nënkryetarë të Kuvendit nga komuniteti

pakicë joserb dhe serb. Përfaqësuesja nga komunitetet joserbe, Emilija Rexhepi është zgjedhur nënkryetare e Kuvendit. Por, procesi ka ngecur kur ka ardhur puna te zgjedhja e nënkryetarit nga komuniteti serb. Lista Serbe, e cila në Kuvend ka 9 nga 10 vendet e rezervuara për serbët, ka këmbëngulur ta propozonte Sllavko Simiqin. Megjithatë, ai nuk ka arritur t’i sigurote 61 votat e nevojshme as pas tri rundeve të votimit. Pasi Lista Serbe nuk ka pranuar të propozonte dikë tjetër për nënkryetar, Basha ka vendosur të hidhte short,

sipas Rregullores së punës së Kuvendit, për të nxjerrë një emër tjetër nga komuniteti serb. Përveç të gjithë deputetëve të Listës Serbe, për këtë post është propozuar edhe Nenad Rashiq nga partia serbe Për Liri, Drejtësi dhe Mbijetesë, aktualisht ministër në detyrë në qeverinë e Albin Kurtit. As Rashiqi nuk i ka marrë votat e nevojshme. Pasi të gjithë deputetët serbë janë hedhur në votim nga tri herë dhe dështuan të zgjedheshin në postin e nënkryetarit, Basha në mënyrë të njëanshme e ka mbyllur seancën konstituive dhe deklaroi se Kuvendi është konstituuar.



NGËRÇI NË KUVEND: KUR POLITIKA NDESHET ME KUSHTETUTËN

Ngërçi në konstituimin e Kuvendit të Kosovës ka nxitur debate të forta mbi interpretimin e Kushtetutës dhe rolin e partive politike. Ndërkohë që Gjykata Kushtetuese ka dhënë disa aktgjykime, zbatimi i tyre ka mbetur i pjesshëm, duke ngritur pyetje mbi nevojën e ndryshimeve të mundshme kushtetuese

PRISHTINË, 5 SHTATOR - Gjykata Kushtetuese ka dhënë tashmë dy aktgjykime për konstituimin e Kuvendit të Kosovës dhe së paku edhe një i tretë pritët. Paqartësitë dhe dyshimet për hapat e ndërmarrë në këtë proces i kanë detyruar partitë politike t'i drejtohen instancës më të lartë për interpretimin e Kushtetutës. Nga debati mbi votimin e fshehtë deri te zgjedhja e ndarë e nënkryetarëve nga komunitetet pakicë, një sërë çështjesh janë vënë nën lupën e kushtetutshmërisë. Por, edhe pse aktgjykimet janë shpallur, ato nuk janë zbatuar plotësisht. Vendimi i 26 qershorit, që urdhëronte konstituimin e Kuvendit brenda 30 ditësh, është shembulli më i qartë: afati ka kaluar, ndërsa Kuvendi ende nuk është konstituuar plotësisht. Mungesa e masave ndëshkuese në aktgjykimet e Gjykatës ka lënë hapësirë për interpretime

të ndryshme - si nga politikanët, ashtu edhe nga ekspertët ligjorë. Një prej pyetjeve që qarkullon në mesin e komentuesve është: a mund të quhet Kuvendi funksional me një kryetar dhe katër nënkryetarë, siç është sot? Kushtetuta e përcakton qartë: Kuvendi duhet të ketë një kryetar dhe pesë nënkryetarë, dhe nuk përmend ndonjë formulë tjetër. Por, në këtë vakum institucional shtrohet edhe një çështje tjetër: a është koha për ndryshime kushtetuese që do të sillnin më shumë qartësi, apo, thjesht, më shumë hapësirë për interpretime të reja? Disa ekspertë të së drejtës kushtetuese dhe analistë politikë, me të cilët bisedoi "Radio Evropa e Lirë", nuk e shohin të domosdoshëm ndryshimin e Kushtetutës së Kosovës. Sipas tyre, ngërçi aktual në konstituimin e Kuvendit nuk buron nga paqartësitë kushtetuese, por nga mungesa

e vullnetit politik të partive. "Në parim, kushtetutat janë të hartuara që të jenë të parashikueshme për një kohë të gjatë dhe që dilemat eventuale rreth përmbajtjes së normave kushtetuese të zgjidhen përmes interpretimit kushtetues", thotë Visar Morina, profesor i së Drejtës Kushtetuese në Universitetin e Prishtinës. Sipas tij, ndryshimet e shpeshta do të zbehnin vetë rolin e Kushtetutës. "... do të prodhonin pasiguri juridike dhe do ta bënin atë një akt fleksibil, përmbajtja e të cilit ndryshon varësisht nga konstelacioni i dinamikave politike në vend", thotë Morina në një përgjigje me shkrim për "Radion Evropë e Lirë". Kushtetuta e Kosovës u miratua më 9 prill të vitit 2008 dhe hyri në fuqi më 15 qershor të po atij viti. Ajo u ndryshua disa herë, si për të shënuar fundin e mbikëqyrjes ndërkombëtare të pavarësisë së Kosovës më 2012,

apo për të përfshirë Konventën e Këshillit të Evropës kundër dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje më 2020. Morina kujton se për të shmangur ndryshimet e shpeshta, Kushtetuta e Kosovës përmban kritere të rrepta materiale dhe procedurale: ato lejojnë amendamente vetëm kur janë realisht të domosdoshme për një objektiv kushtetues, i cili nuk mund të arrihet përmes mjeteve të tjera, si interpretimi kushtetues. Kushtetutat nuk janë kurrë dokumente të përkryera dhe me gjuhë plotësisht të qartë, sipas tij. "Kushtetuta e Kosovës nuk bën përjashtim nga ky standard. Së pari, ato (kushtetutat) përcaktojnë vetëm parimet themelore të funksionimit të shtetit dhe nuk është e pritshme që të përmbajnë detaje për çdo situatë konkrete", thekson Morina. Ai shton se gjuha e gjerë që përdoret zakonisht në kushtetuta është e qëllimshme, pasi lë hapësirë për interpretim. Kjo, sipas tij, u mundëson gjykatave kushtetuese dhe praktikës gjyqësore t'i plotësojnë boshllëqet përmes jurisprudencës dhe zhvillimit të

doktrinës. Njohësi i çështjeve politike, Avni Arifi, vlerëson gjithashtu se Kushtetuta nuk ka nevojë të ndryshohet për të shmangur ngërçet institucionale, si ai aktual. "Kushtetuta e Republikës së Kosovës nuk mund t'i zëvendësojë partitë politike. Nëse partitë politike duan të devijojnë nga Kushtetuta, atëherë Gjykata Kushtetuese nuk mund ta mbrojë Kushtetutën", thekson Arifi për "Radion Evropë e Lirë". Konstituimi i Kuvendit ngaci te zgjedhja e nënkryetarit serb. Lista Serbe, si partia më e madhe në Kuvend, propozoi vetëm një kandidat, i cili në tri runde votimi nuk i mori votat e mjaftueshme. Kryetari i Kuvendit, Dimal Basha, ndryshe nga ajo që shkruan në Kushtetutë, hodhi shortin për të përcaktuar kandidatin tjetër serb, dhe ndryshe nga praktikat e deritashme, nuk e futi për t'u votuar në paketë me kandidaten e pakicave joserbe. Asnjëri prej nëntë kandidatëve të zgjedhur me short, nuk mori 61 votat e kërkuara. "Kushtetuta është e qartë dhe i jep të drejtë shumicës së deputetëve të komunitetit serb që ta propozojë nënkryetarin", thotë

REAGIM I KËSHILLIT PËR MBROJTJEN E TË DREJTAVE DHE LIRIVE TË NJERIUT (KMDLNJ)

DHUNIM I TË DREJTAVE TË NJERIUT NË BURGUN E HAGËS

“KMDLNj ishte informuar se oficerë të burgut nuk kanë sjellje të mira me të paraburgosurit në ndërkohë që njëfarë John dallohej për arrogancën dhe kërcënimin ndaj pengjeve të Hagës. Për atë fillimisht roje pastaj mbikëqyrës u mor vesh identiteti vetëm kur u paraqit si prokuror i Zyrës së Prokurorisë Speciale pranë Gjykatës Speciale Raciste në Hagë. KMDLNj e stërpërsërit reagimin dhe ngre shqetësimin për ata që kanë sy dhe veshë në Kosovë për shkelje brutale të të drejtave të njeriut të pengjeve të Hagës, të gjithë shqiptarë dhe të gjithë shtetas të Kosovës!”, është theksuar në reagimin e Këshillit për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive të Njeriut (KMDLNj)

Që nga koha e pandemisë, gjatë takimeve të shumta me avokatë dhe anëtarë të ekipeve mbrojtës si dhe me familjarë të pengjeve që po mbahen në Hagë, të gjithë shqiptarë dhe shtetas të Kosovës, KMDLNj ishte informuar se oficerë të burgut nuk kanë sjellje të mira me të paraburgosurit në ndërkohë që njëfarë John dallohej për arrogancën dhe kërcënimin ndaj pengjeve të Hagës. Për atë fillimisht roje pastaj mbikëqyrës u mor vesh identiteti vetëm kur u paraqit si prokuror i Zyrës së Prokurorisë Speciale pranë Gjykatës Speciale Raciste në Hagë. Reagimin dhe kundërshtimin me shkrim e kishte bërë presidenti Thaçi por se nuk kishte një reflektim nga GJRS. KMDLNj ka reaguar shumë herë ndaj shkeljeve të të drejtave të njeriut të personave të privuar nga liria por se institucionet e shtetit nuk kishin reaguar fare ndonëse i kishin në tavolinë problemet e

identifikuara. Reagimi joeventual por i detyrueshëm i institucioneve të Kosovës në asnjë mënyrë nuk nënkupton ndërhyrje në pavarësinë e procesit gjyqësor por interesim për të drejtat e njeriut aq më parë që thuhet se GJSR është pjesë e sistemit gjyqësor të Kosovës pasi është votuar në Kuvendin e Kosovës. Në GJSR në Hagë mund të gjeni shumëçka që identifikohet me Serbinë por asgjë që identifikohet me Kosovën. Që nga procesi i Nyrembergut e deri në ditët tona nuk ka proces të kësaj natyre me shkelje aq të rënda të drejtave të njeriut se tani në Hagë. Të drejtat e tyre nuk i mbron as Komiteti për Parandalimin e Torturës dhe Trajtimit Degradues i Kombeve të Bashkuara, as Komiteti Ndërkombëtar i Kryqit të Kuq në Gjenevë e as Avokati i Popullit i Holandës, i cili më shumë ngjason të jetë pjesë e stafit të Zyrës së Prokurorit të



Specializuar se që është i detyruar ta përmbushë mandatin si mbrojtës i të drejtave të njeriu të personave të privuar nga liria. Pengjet e Hagës janë nën mëshirën e kriminelëve juridikë që udhëhiqen nga gjyqtarja e Todor Zhivkovit të Bullgarisë komuniste, tash kryetare e GJSR dhe rrugaçeve që, në rrethana normale do të duhej të kujdesen për ta kurse, të papenguar nga askush dhe në një terr informativ ushtrojnë terror psikik dhe kërcënojnë me dhunë fizike ndaj pengjeve, të gjithë shqiptarë dhe të gjithë shtetas të Kosovës. Me mosveprim apo me deklarata

publike të dëmshme, ndihmesë të madhe GJSR i kanë dhënë Albin Kurti dhe Albulena Haxhiu, kundërshtarë të rreptë të pengjeve të Hagës dhe tifozë pasionantë për dënimin e tyre. Këta do të mbahen mend si kontribuuesit më të mëdhenj të shkeljeve të drejtave të njeriut të pengjeve të Hagës. Në pamundësi të realizimit të drejtave të njeriut dhe në mungesë të adresës ku do të kërkonin që këto drejta t'u mbrohen, pengjet e Hagës është dashur të hyjnë në grevë urie si masë e skajshme për ta sensibilizuar rastin kurse avokatët për të drejtat e njeriut

duhet të padisin rojet e dhunshme, të papërgjegjshme dhe pandërgjegjshme. Standardet më të larta të Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Njeriut të peronave të privuar nga liria të përmbledhura në “Regullat e Nelson Mandelës” e që kinse zbatohen në Burgun e Hagës janë improvizim dhe perde tymi për të mashtruar opinionin, asgjë më shumë. KMDLNj e stërpërsërit reagimin dhe ngre shqetësimin për ata që kanë sy dhe veshë në Kosovë për shkelje brutale të të drejtave të njeriut të pengjeve të Hagës, të gjithë shqiptarë dhe të gjithë shtetas të Kosovës!

Arifi. Lista Serbe iu drejtua pastaj Kushtetueses për mënyrën e votimit të nënkryetarit serb.

Çfarë thonë partitë politike?

Nëse duhet apo jo të bëhen ndryshime kushtetuese për të shmangur ngërçet institucionale, deputetët e partive parlamentare ndajnë mendime të ndryshme. Arbër Rexhaj, deputet i Lëvizjes Vetëvendosje, thotë për “Radion Evropa e Lirë” se sa i përket konstituimit të Kuvendit dhe bllokadës që ka zgjatur prej muajsh, Kushtetuta ofron zgjidhje të qarta dhe, sipas tij, nuk ka nevojë për ndryshime. “Deputetët i kanë shfrytëzuar të gjitha të drejtat kushtetuese për të votuar”, thotë Rexhaj. Ndryshe nga ai, Nait Hasani, deputet i Partisë Demokratike të

Kosovës, vlerëson se ngërçi në konstituimin e Kuvendit ka dëshmuar se Kosova ka hyrë në një fazë politike ku ndryshimet kushtetuese janë të domosdoshme për të ofruar zgjidhje të qarta dhe për të shmangur situata të ngjashme në të ardhmen. Në këtë drejtim, ai i sheh si të nevojshme sidomos ndryshimet që lidhen me mënyrën e zgjedhjes së presidentit. Sipas tij, presidenti duhet të zgjidhet drejtpërdrejt nga qytetarët dhe jo nga deputetët e Kuvendit, siç ndodh aktualisht, dhe shpjegon përse: “Kjo do t'i shkarkonte mundësitë e kombinacioneve politike për krijimin e Qeverisë dhe konstituimin e Kuvendit. Partitë që dalin në zgjedhje, partia e parë [fituese] e ka më të lehtë me partinë e dytë ose të tretë të bëjë kombinime të qeverisjes, në rast se nuk do të ishte në këtë

kombinim posti i presidentit”. Nga ana tjetër, Lutfi Haziri, deputet i Lidhjes Demokratike të Kosovës, vlerëson se ngërçi aktual në Kuvend nuk lidhet me paqartësitë kushtetuese, por me mungesën e gatishmërisë së partive politike për të bashkëpunuar në zbatimin e frymës së Kushtetutës. Sipas tij, kjo mungesë vullneti ka bërë që partitë politike t'i drejtohen Gjykatës Kushtetuese, e më pas t'i riinterpretojnë edhe vetë vendimet e saj. “Më eksplicite se i ka Kushtetuta jonë, asnjë kushtetutë nuk i ka... shumë eksplicite i ka të drejtat dhe mekanizmat. Krejt problemi është politik. Duke u thirrur në procedura e rregullore, mundohen ta deformojnë frymën kushtetuese. Ky është problemi. Kushtetuta nuk ka asnjë problem”, sipas Hazirit. Partia tjetër në Kuvend, Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës, nuk

iu përgjigj kërkesës së “Radios Evropa e Lirë” për të komentuar në këtë temë. Sidoqoftë, për çdo ndryshim kushtetues janë të domosdoshme dy të tretat e votave të të gjithë deputetëve të Kuvendit, si dhe dy të tretat e votave të deputetëve që përfaqësojnë komunitetet joshumicë. Morina, edhe pse nuk e sheh të nevojshëm ndryshimin e Kushtetutës së Kosovës tash për tash, thotë se, në parim, ajo duhet të mbetet e hapur ndaj evoluimit shoqëror, pasi realitetet politike, ekonomike dhe shoqërore ndryshojnë vazhdimisht. Në të njëjtën kohë, ai përmend edhe “klauzolat e përjetshme”, të cilat “për shkak të karakterit fundamental që kanë, nuk mund të jenë objekt i ndryshimit kushtetues”. “Në rastin e Kosovës këtu do të mund të

hynte, pa diskutim, pakësimi i lirive dhe të drejtave kushtetuese”, thotë mes tjerash Morina. Opinioni publik tani është në pritje të vendimit të Gjykatës Kushtetuese mbi kërkesën e Listës Serbe. Kësaj gjykate i është drejtuar më herët edhe presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani, me kërkesën për të sqaruar se çfarë ndodh në rast se nuk respektohet afati 30-ditor për konstituimin e Kuvendit, i vendosur nga gjykata. Më pas, Osmani e ka tërhequr kërkesën, duke u bazuar në faktin se gjykatësin Radomir Llaban, i cili ishte raportues për këtë rast, e konsideron “rrezik për sigurinë kombëtare”. Megjithatë, njohës të çështjeve kushtetuese vlerësojnë se, edhe pas tërheqjes së kërkesës nga Osmani, Gjykata ka të drejtë të vazhdojë procedurën.

Në prag të 26-vjetorit të Policisë së Kosovës mbahen aktivitete në sheshin "Zahir Pajaziti"

PRISHTINË, 5 SHTATOR - Në prag të 26-vjetorit të themelimit të Policisë së Kosovës u organizuan të premtën një sërë aktivitete në sheshin "Zahir Pajaziti" në Prishtinë. Në këtë ngjarje morën pjesë zyrtarë të lartë dhe nxënës të shkollave fillore. Ministri i Brendshëm në detyrë, Xhelal Sveçla, uroi përvjetorin dhe theksoi përkushtimin e policisë për t'u shërbyer qytetarëve, veçanërisht fëmijëve.

Ai theksoi se policia është një partner i besueshëm për gjeneratat e reja. "Në prag të 26 vjetorit të themelimit të Policisë së Kosovës, sot festuam me fëmijët, të tashmen e sigurt dhe të ardhmen e ndritur të vendit tonë. Në kuadër të aktiviteteve të shumta, ata patën mundësinë të njihen nga afër me kapacitetet dhe shkathhtësitë e policisë sonë, e cila çdo ditë e pa kursim angazhohet për sigurinë e tyre



dhe të gjithë qytetarëve të Republikës së Kosovës. Fëmijët janë motivi ynë i përditshëm dhe arsyeja që punojmë me përkushtim për një të ardhme më të sigurt për

të gjithë", ka thënë Sveçla. Ndërkaq, drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Kosovës, Gazmend Hoxha, ka theksuar se policia mbetet institucioni më i besuar në vend, duke përkujtuar 26 heronjtë e rënë në mbrojtje të sigurisë dhe integritetit të vendit. Ai inkurajoi të rinjtë që të mësojnë dhe të shohin Policinë si një derë gjithmonë të hapur. "Në këto 26 vite ne i kemi dhënë 26 heronj në luftë

kundër krimit dhe integritetit territorial të Republikës. Është një institucion i besueshëm i vendit tonë, policët tanë i kanë shërbyer vendit për gjatë 26 viteve. Ne vazhdojmë të punojmë që këtë përkushtim ta çojmë edhe më tutje, të vazhdojmë dhe të avancohemi edhe më tutje në aspektin profesional. Porosia për fëmijët: vazhdoni të mësoni, dyert e Policisë do të jenë të hapura", ka thënë Hoxha.

28 VJET NGA VDEKJA E SHËN NËNË TEREZËS, RRUGËTIMI I SAJ FRYMËZOI MILIONA NJERËZ

PRISHTINË, 5 SHTATOR - Të premtën janë bërë 28 vjet nga vdekja e Shën Nënë Terezës. Me këtë rast presidentja Vjosa Osmani ka thënë se rrugëtimi i Shën Nënë Terezës frymëzoi miliona njerëz. Presidentja ka theksuar se veprat e Shën Terezës na kujtojnë fuqinë e bamirësisë dhe humanizmit, prandaj trashëgimia e saj është një thirrje për secilin prej nesh: të jemi pranë të tjerëve. "Nga fshati i vogël i Letnicës, ku dëgjoi thirrjen hyjnore, në Sheshin "Shën Pjetri" në Vatikan dhe pastaj në çdo anë të botës, Nënë Tereza i dha zë të varfërve, të sëmurëve dhe të harruarve, duke lënë pas një trashëgimi të pakrahasueshme bamirësie dhe humanizmi. Rrugëtimi i saj frymëzoi miliona njerëz. Veprat e Shën

Terezës na kujtojnë fuqinë e bamirësisë dhe humanizmit, prandaj trashëgimia e saj është një thirrje për secilin prej nesh: të jemi pranë të tjerëve, të dhurojmë dashuri dhe shpresë, si dhe ta ndërtojmë një botë më të drejtë dhe më paqësore", ka shkruar Osmani në "Facebook". Kryetari i PDK-së, Memli Krasniqi, ka thënë se duhet ta mbajmë gjallë kujtimin e Nënë Terezës, duke i jetësuar porositë që na i la pas. "Në 28-vjetorin e kalimit në përjetësi të Nënës Terezë, kujtojmë me nderim gruan e jashtëzakonshme që u bë simbol i dashurisë pa kufij. Me përkushtim të palodhur, dashuri të thellë dhe vetësakrificë të rrallë, ajo u kujdes për mijëra fëmijë, të sëmurë, të varfër e të braktisur në çdo cep të botës, pa kërkuar asnjëherë lavdi", ka shkruar në



"Facebook" kryetari i PDK-së, Memli Krasniqi. Ai ka kujtuar edhe një thënie të Nënë Terezës. "‘Nuk ka rëndësi sa shumë bëjmë, por sa shumë dashuri vendosim në atë që bëjmë’ - kjo është vetëm një nga thëniet e shumta me vlerë që i la si trashëgimi Nëna Terezë", ka shkruar Krasniqi. Ai ka thënë se Nënë Tereza mbetet frymëzim për të rinjtë që ëndërrojnë të bëjnë ndryshim, për nënat që sakrifikojnë çdo ditë për fëmijët e tyre, për mësuesit e mjekët që japin nga vetja pa kursim, për të moshuarit që na mësojnë me urtësi, e për çdo njeri që beson se dashuria dhe shërbimi ndaj tjetrit janë forca më e madhe e jetës. "Ta mbajmë gjallë kujtimin për të, duke i jetësuar çdo ditë porositë që na i la pas", ka shkruar Krasniqi.

SHEFI I ZYRËS SË BE-SË TAKON BASHËN, SHPREH RËNDËSINË E FUNKSIONALIZIMIT TË INSTITUCIONEVE



PRISHTINË, 5 SHTATOR - Kreu i Kuvendit të Republikës së Kosovës, Dimal Basha, ka prituri në takim shefin e zyrës së Bashkimit Evropian në Kosovë, Aivo Orav. Basha dhe përfaqësuesi i BE-së diskutuan lidhur me ngjarjet e fundit politike në Kosovë dhe biseduan për rëndësinë e një legjislature efektive për realizimin e politikave integruese në BE. Basha e falënderoi përزمërsisht ambasadorin e

Bashkimit Evropian për mbështetjen e vazhdueshme dhe të madhe që Bashkimi Evropian i ka dhënë Kosovës në të gjitha fazat e shtetndërtimit, në fusha të ndryshme dhe me projekte të shumta ndër vite. Në takim, kryetari Basha theksoi rëndësinë e largimin të masave ndaj vendit tonë, si dhe praninë e Kosovës në Këshillin e Evropës, si një mekanizëm shtesë që garanton avancimin e lirive dhe drejtave të njeriut për të gjithë qytetarët e vendit tonë.

Nga ana e tij, shefi i zyrës së BE-së, Orav, e uroi Bashën për detyrën e re si kryetar i Kuvendit të Republikës së Kosovës dhe shprehu rëndësinë e funksionalizimit të institucioneve si dhe gatishmërinë për vazhdimin e bashkëpunimit të ngushtë dhe mbështetjes së fuqishme të Bashkimit Evropian për Kosovën, e cila është një marrëdhënie thelbësore për zhvillimin e vendit dhe integrimin e tij të plotë në strukturat evropiane.

Certifikohen 48 pjesëtarë të rinj në Njësinë Speciale Operative të Policisë së Kosovës

PRISHTINË, 5 SHTATOR - Në kampin e Njërive Speciale - Vrella, u mbajt ceremonia solemne e certifikimit të 48 pjesëtarëve të rinj të Njësisë Speciale Operative, të cilët me sukses përfunduan një trajnimin bazik për operatorë të NJSO-së. Në këtë ceremoni morën pjesë drejtori i Përgjithshëm i Policisë

së Kosovës, kolonel Gazmend Hoxha, drejtor i Departamentit të Njërive Speciale kolonel Shabani, eprorë të PK-së, instruktorë, përfaqësues nga Ambasada Amerikane, KFOR-i amerikan si dhe zyrtarë të institucioneve shtetërore. Kjo ceremoni është përmbyllje e një rrugëtimi profesional ku kandidatët më të përgatitur, më

të qëndrueshëm dhe më të vendosur, janë bërë pjesë e kësaj njësie elitare të Policisë së Kosovës. Po ashtu në këtë ceremoni u certifikuan edhe 5 instruktorë të trajnimit themelor për NJSO-në si dhe u ndanë mirënjohje për instruktorët për kontributin dhe punën e palodhshme të tyre në trajnimin e kësaj

gjenerate të operatorëve të rinj të NJSO-së. Këta pjesëtarë të rinj, të përgatitur nga instruktorë me përvojë dhe përkushtim të lartë, janë tashmë gati të përballen me detyrat dhe sfidat policore - gjithmonë në mbrojtje të rendit, ligjit dhe sigurisë, në shërbim të qytetarëve dhe të Republikës së Kosovës.



RAMA I DREJTOHET KUSHTETUESES PËR BUXHETIN E PRISHTINËS

PRISHTINË, 5 SHTATOR - Kryetari i Komunës së Prishtinës, Përparim Rama, i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese me një lëndë kundër Ministrisë së Financave, për siç ka thënë, cenimin e buxhetit të kryeqytetit. Ai ka akuzuar ministrin në detyrë të Financave, Hekuran Murati, për bllokadë politike ndaj Komunës së Prishtinës. Rama tha për mediat se bëhet fjalë për 35 milionë euro, që sipas tij, ligjërisht i takojnë kryeqytetit, e të cilat, sipas kreut të Prishtinës, janë të bllokuar që nëntë muaj. “Fondet tona, fondet të cilat me ligj i takojnë kryeqytetit, qytetarëve të kryeqytetit dhe shpenzohen për të mirën e kryeqytetit, janë të bllokuara tash e nëntë muaj. Pra, e keni parë gjatë këtyre katër vjetëve, në instanca të ndryshme kjo qeverisje ka bërë bllokada në nivele të ndryshme. Prej

fillimit, prej unazës së kryeqytetit ku e kanë bllokuar procesin e zhvillimit të unazës, ku 82.4 milionë prej 206 milionëve kanë qenë falas, por për çështje puro politike ministri [në detyrë i Financave] Murati e ka bllokuar procesin”, theksoi Rama, raporton REL.

Ku qëndron problemi?

Në Ligjin për menaxhimin e financave publike në Kosovë përcaktohet se komunat kanë afat deri më 30 shtator për ta miratuar buxhetin e vet për vitin pasues fiskal. Nëse nuk e respektojnë këtë afat, ato humbin të drejtën për ta propozuar vetë buxhetin për vitin e ardhshëm, ndërsa Ministria e Financave e harton një version të buxhetit për to, i cili zakonisht bazohet në shifrat e buxhetit ekzistues. Komuna e Prishtinës më 9



dhjetor 2024 - pra me vonesë - e ka miratuar buxhetin për vitin 2025 në vlerë prej 128 milionë eurosh, rreth 6 milionë euro më i lartë sesa ai i vitit paraprak. Në situatë të ngjashme janë edhe Gjilani dhe Zubin Potoku. Buxhetet e reja të tyre nuk janë përfshirë në Ligjin

mbi ndarjet buxhetore për vitin 2025, i cili është miratuar paraprakisht në nëntor nga Kuvendi i Kosovës. Për shkak se buxheti i Komunës së Prishtinës është miratuar pasi është miratuar Ligji për buxhetin, është kërkuar të ndryshohet ky ligj, i cili ka kaluar në Qeveri, por jo

edhe në Kuvend të Kosovës. Por, ai tani as nuk mund të kalojë, pasi ka paqartësi lidhur me konstituimin e Kuvendit. Sipas Ligjit për menaxhimin e financave publike, kur buxheti i ri i një komune nuk përfshihet në Ligjin për buxhetin, për shkak të vonesës në miratimin e tij, Ministria e Financave autorizon shpenzime mujore në nivelin e një të dymbëdhjetës së buxhetit të vitit të kaluar për çdo muaj, deri në fund të muajit qershor. Pas kësaj periudhe, nuk mund të autorizohen fonde për kategori të tjera, përveç pagave dhe obligimeve të detyrueshme, dhe ato kërkojnë miratim nga kuvendi komunal çdo muaj. Kategoritë, si investimet kapitale, mallrat, shërbimet dhe subvencionet, mbesin të bllokuara.

URAN ISMAILI: NËSE NUK I PËRMBUSH 90% TË PREMTIMEVE, NUK KANDIDOJ PËR HERË TË DYTË

PRISHTINË, 5 SHTATOR - Kandidati i PDK-së për kryetar të Prishtinës, Uran Ismaili, ka deklaruar se rikandidimi i tij ka ardhur si kërkesë e drejtpërdrejtë nga qytetarët, ndërsa programi që po prezanton është ndërtuar pikërisht mbi nevojat dhe kërkesat e tyre. “Unë jam këtu për të fituar, dhe aleanca ime e vetme është me qytetarin e Prishtinës. Nëse qytetarët ma japin mundësinë, unë do t'i realizoj të gjitha premtimet e mia, të cilat sot ata i kanë të ditura, të detajuara me numra të saktë”, tha Ismaili. Ai theksoi se të gjitha problemet në Prishtinë janë të zgjidhshme, mjafton të dish si dhe të duash t'i zgjidhësh. Sipas tij, kryeqyteti ka potencial të plotë për t'u zhvilluar, por kjo kërkon një qeverisje të përgjegjshme. Për dallim nga kryetari aktual, Ismaili tha se ai nuk do ta fshijë



listën e premtimeve kur të vijë koha për t'u përballur me qytetarët, por do të japë llogari mbi bazën e zotimeve të tij specifike, numerike dhe të matshme. Ismaili ka dhënë një zotim të fortë para qytetarëve, duke

thënë se puna e tij do të matet vetëm me realizimin e premtimeve. “Nëse nuk i përmbush 90% të premtimeve, nuk kandidoj për herë të dytë. Do ta pranoj që nuk kam qenë i denjë për një mandat tjetër”, tha ai në RTV Dukagjini.

Ismaili shtoi se Prishtina është qyteti i tij, ku jeton me familjen dhe rrit fëmijët, dhe se e njeh kryeqytetin në çdo pore të tij bashkë me problemet që i rëndojnë qytetarët. Ai theksoi se përvoja e tij si ish-ministër i Shëndetësisë, ku ka zbatuar reforma që vazhdojnë të japin rezultate, është dëshmi se di të sjellë zgjidhje edhe për kryeqytetin. “Unë nuk kam vija partiake - do t'i shërbej vetëm qytetarëve të Prishtinës”, përfundoi ai. Ismaili ka thënë se posedon aftësinë dhe përvojën menaxheriale për të zgjidhur njëherë e përgjithmonë problemet e mëdha me të cilat kryeqyteti është përballur për vite të tëra. Ai theksoi se qytetarët e Prishtinës meritojnë një jetë më të mirë dhe se është i bindur se mund ta nxjerrë kryeqytetin nga kaosi në të cilin ndodhet. Duke folur për premtimin e tij

“prej betonit te komuniteti”, ku është zotuar se do të pezullojë për gjashtë muaj të gjitha lejet e reja të ndërtimit, për të krijuar mundësinë e një planifikimi të rregullt urban. Ai sqaroi se lejet ekzistuese nuk do të preken, por theksoi se Prishtina duhet të ndërtohet me plan dhe me rregull. “Shumica e lagjeve të ndërtuara sot nuk kanë infrastrukturë mbështetëse - nuk kanë parqe, çerdhe, ndriçim, apo hapësira sociale. Komuna ka dhënë leje pa menduar për pasojat dhe pa vendosur infrastrukturën e nevojshme. Pezullimi prej 6 muajsh është i domosdoshëm që ndërtimet e reja të planifikohen më mirë dhe t'u ofrojnë qytetarëve, rrugë, ndriçim, parqe, çerdhe, gjelbërim dhe infrastrukturë sociale dhe një jetë më kualitative në përgjithësi”, tha Ismaili.

Operacioni policor për 'fajde' dhe 'shpërlarje parash' rezulton me dy persona të arrestuar

Prishtinë, 5 shtator- Policia e Kosovës, respektivisht hetuesit nga Drejtoria për Hetimin e Krimit të Organizuar dhe Krimeve të Rënda, pas zhvillimit të veprimeve hetimore me urdhër të Prokurorisë Speciale, kanë arrestuar të premtin B.M dhe Q.M, nën dyshimet për kryerjen e veprave penale “fajde”, “shpërlarje e parave”, “kanosje”, “falsifikim i dokumenteve”, dhe

“mashttrim”. Hetuesit policorë me autorizim të Prokurorisë Speciale, më 05.09.25 kanë zbatuar urdhër kontrollin e lëshuar nga Gjykata Themelore në Prishtinë, në katër lokacione (shtëpi, banesa, biznese dhe objekte përcjellëse) të personave të dyshuar, me ç'rast janë gjetur dhe sekuestruar dëshmi materiale, të cilat do të përdoren në procedurën penale ndaj të dyshuarve.

Pas intervistimit, me vendim të prokurorit nga Prokuroria Speciale, dy të dyshuarit janë ndaluar për 48 orë. Policia e Kosovës, në bashkëpunim dhe koordinim me Prokurorinë Speciale, mbetet e përkushtuar që në vazhdimësi të trajtojë informacionet dhe dyshimet me profesionalizëm, në mënyrë që të gjithë kryesit e veprave penale të vihen para përgjegjësisë ligjore.



ATK-ja shënon rritje të qëndrueshme të të hyrave në periudhën janar - gusht

PRISHTINË, 5 SHTATOR - Administrata Tatimore e Kosovës ka arritur që në periudhën janar - gusht të 2025 të mbledhë gjithsej 713.3 milionë euro të hyra, duke tejkaluar të hyrat e së njëjtës periudhë të vitit 2024 për 71.2 milionë euro. “Ky rezultat dëshmon për një trend të qëndrueshëm të rritjes së të

hyrave tatimore, që pasqyron jo vetëm përkushtimin e ATK-së në zbatimin e ligjit dhe forcimin e administrimit tatimor, por edhe vetëdijen gjithnjë e më të lartë të tatimpaguesve për përmbushjen e obligimeve të tyre”, ka njoftuar ATK-ja. Sipas këtij institucioni, rritja e të hyrave ka rëndësi të veçantë për stabilitetin fiskal të vendit,

sepse garanton më shumë mjete për investime publike, zhvillim ekonomik dhe përmbushjen e nevojave të qytetarëve. “Kjo është dëshmi se partneriteti i ndërtuar ndërmjet ATK-së dhe tatimpaguesve po jep rezultate të prekshme dhe afatgjata”, theksohet në njoftimin për medie.

Në këtë kuadër, ATK-ja rikujton se qëllimi i saj nuk është ndëshkimi i tatimpaguesve, por edukimi dhe ndërgjegjësimi i tyre, me qëllim që obligimet tatimore të trajtohen si përgjegjësi e natyrshme qytetare dhe biznesore. “Prandaj, institucioni do të vazhdojë të investojë në trajnime, fushata informuese



dhe shërbime digjitale që u lehtësojnë tatimpaguesve procesin e përmbushjes së obligimeve”, ka njoftuar ATK-ja.

TRI KOMPANI TË REJA LICENCOHEN PËR FURNIZIM ME ENERGJI ELEKTRIKE

EPOKA E RE Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 5 SHTATOR - Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRRë) ka mbajtur të premten mbledhjen e radhës, në të cilën ka miratuar disa kërkesa për licencim dhe autorizime për furnizim, prodhim dhe vetëkonsum të energjisë elektrike.

Janë miratuar aplikimet për licencim të aktivitetit të furnizimit me energji elektrike për kompanitë Norwegian PX Kosovë Sh.P.K., BE Power Sh.P.K. dhe Energy for Change L.L.C. Anëtar i Bordit të ZRRë-së, Ymeridin Misini, ka thënë se kompanitë kanë përmbushur të gjitha kërkesat ligjore. “Kompanitë kanë dorëzuar aplikacionet për marrjen e



licencave për furnizim. Dokumentet i kanë plotësuar në përputhje me kërkesat, po ashtu edhe dëshmitë. Konsideroj se aplikacioni është vlerësuar sipas rregullave dhe në përputhje me legjislacionin për një periudhë 5-vjeçare, si licencat tjera”, është shprehur Misini.

Po ashtu, u miratua licencimi i

aktivitetit të prodhimit të energjisë elektrike për Energy Development Group Kosova L.L.C. “Kompania në fjalë ka aplikuar pranë ZRRë-së. Projekti konsiderohet i ndërtuar, pasi janë plotësuar kushtet ligjore dhe janë dorëzuar dokumentet nga komuna përkatëse. Janë sjellë të gjitha dëshmitë, është

kryer edhe publikimi në gazetën online. Mbështetur në Ligjin për ZRRë-në për prodhimin e energjisë elektrike, licenca lëshohet për një periudhë kohe derisa pajisjet të jenë funksionale. Propozohet që kësaj ndërmarrjeje t'i lëshohet licenca për një periudhë 25-vjeçare”, ka deklaruar Misini.

Në këtë mbledhje ky bord ka miratuar edhe dhënien e autorizimit për ndërtim për subjektin juridik Lindja Solar L.L.C., me kapacitet prej 100 MW në zonën kadastrale Kramovik dhe Petkoviq të Rahovecit. “Lokacioni është në zonën kadastrale Kramovik dhe Petkoviq. Në kuadër të parkut solar është planifikuar të ndërtohen stacioni qendror, objekti administrativ teknik, si dhe nënstacioni brenda parkut.

Bordit i propozohet të lëshohet autorizim për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese për prodhim të energjisë elektrike nga panelet solare me kapacitet 100 MW”, ka pohuar Misini.

Kryesuesi i Bordit të ZRRë-së, Ymer Fejzullahu, ka theksuar rëndësinë e këtij projekti. “Është një nga projektet e para që ka kaluar përmes procedurave konkurruese, që është kërkesë e BE-së që të kalohet sa më parë në këtë procedurë. Ky është projekti i parë dhe shpresojmë që nuk do të jetë i fundit. Është nevojë për sektorin e energjisë dhe kemi nevojë për kapacitete shtesë”, ka thënë Fejzullahu.

Ndër vendimet tjera, u miratuan edhe dhjetëra kërkesa për autorizime për vetëkonsum, për kompani dhe persona fizikë.

ZKA-ja EVIDENTON SHKELJE NË PROCESIN E DHËNIES DHE MENAXHIMIT TË PRONËS PUBLIKE NË TETË KOMUNA

EPOKA E RE Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 5 SHTATOR - Për shkak të rëndësisë që ka menaxhimi i pronës publike dhe mangësive të identifikuar në auditimet e mëhershme financiare, Zyra Kombëtare e Auditimit (ZKA) në kuadër të sezonit auditues 2024/2025 ka realizuar tetë auditime të pajtueshmërisë me temën “Dhënia në shfrytëzim dhe menaxhimi i pronave komunale të dhëna me qira”.

Auditimet janë zhvilluar në Komunën e Prishtinës, Prizrenit, Pejës, Gjilanit, Podujevës, Suharekës, Fushë Kosovës dhe Vushtrrisë, duke mbuluar periudhën janar 2023 - dhjetor 2024.

Rezultatet e auditimeve tregojnë se shumica e komunave të audituara nuk kanë zbatuar plotësisht procedurat ligjore, kanë ndryshuar qëllimin e shfrytëzimit të pronave pa miratim, kanë lejuar shfrytëzim afatgjatë jashtë kufijve ligjor, nuk



kanë zbatuar procedura formale për vazhdimin e kontratave, si dhe nuk kanë mbajtur dokumentacionin e nevojshëm dhe nuk kanë mbikëqyrur në mënyrë të rregullt shfrytëzuesit e

pronave. Në disa prej tyre auditimi ka evidentuar raste të përdorimit të pronave pa kontrata valide si dhe tejkallim të kushteve ligjore, gjë që ka dëmtuar të hyrat publike. Po ashtu, raportimi i pamjaftueshëm nga autoritetet ekzekutive ka kufizuar mbikëqyrjen dhe vendimmarrjen e Kuvendeve Komunale. Konkluzioni i auditimit është se komunat e audituara nuk kanë vepruar në përputhje me kornizën ligjore në fuqi për

dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme dhe menaxhimin e kontratave për qiradhënie. Dobësitë në proceset e qiradhënies, mungesa e kontrolleve të brendshme efektive dhe mos mbajtja e regjistrave të sakta kanë ndikuar në zvogëlim të të hyrave komunale, rrezikim të integritetit të pronës publike dhe shkelje të dispozitave ligjore. Për të përmirësuar menaxhimin dhe mbikëqyrjen e pronës publike ZKA-ja ka dhënë 54 rekomandime.

Fillojnë punimet e ujësjellësit në Mamushë, projekti kap vlerën 1,8 milionë euro


Mamushë, 5 shtator - Zëvendësministri i Ekonomisë, Getoar Mjeku, ka marrë pjesë në ceremoninë e përmirimit të fillimit të punimeve të fazës përfundimtare të projektit të ujësjellësit për Mamushë. Përveç zëvendësministrit Mjeku, në ceremoni kanë marrë pjesë edhe ministri në detyrë i Zhvillimit Rajonal, Fikrim Damka, kryetari i Komunës së Mamushës, Abdulhadi Krasniq

dhe kryeshefi i Kompanisë Rajonale të Ujësjellësit “Gjakova”, Hasan Krasniqi. Zëvendësministrit Mjeku ka theksuar se projekti me dy faza, ku faza e parë është në përfundim, kap vlerën e 1,8 milionë eurove, prej të cilave 1,2 milionë janë ndarë nga Ministria e Ekonomisë, ku përveç Mamushës, projekti shërben edhe fshatrat Krushë, Piranë, Zojz e Medvec, duke

sjellë ujin e pijes nga liqeni i Radoniqit. Ai ka vlerësuar se Mamusha, e banuar kryesisht nga komuniteti turk, mirëpriti këtë investim me rëndësi jetike për qytetarët. Po ashtu, Mjeku ka pohuar se Qeveria e Kosovës është e përkushtuar me mbështetë përmirësimin e shërbimeve publike për të gjitha komunitetet e vendit.



ÇUDIA PËR HUAN RULFON



Nga: Gabriel Garcia
MARQUEZ

Zbulimi i Juan Rulfos – si ai i Franc Kafkës – pa dyshim, do të jetë një kapitull themelor në kujtimet e mia. Kisha mbërritur në Meksiko më 2 korrik 1961, pikërisht ditën që Ernest Heminguej i dha fund jetës me një të shtënë. Unë, jo vetëm nuk i kisha lexuar librat e tij, por as që kisha dëgjuar të flitej për të. Jetoja në një apartament pa ashensor, në rrugën Renan, në lagjen Anzures. Kishim një dopio dyshek, për sheshi, në një dhomë gjumi të madhe, një djep në dhomën tjetër, ndërsa në mesore një tavolinë për të ngrënë e për të shkruar dhe dy karrige të vetme që na shërbenin për gjithçka.

Kishim vendosur të qëndronim në këtë qytet i cili ende ruante një përmasë humane, me një ajër të tejdukshëm dhe me bulevardet plot lule me ngjyra të dalldisura, por autoritetet e emigracionit nuk po na i bënë mundur gëzimin tonë. Kësisoj, gjysma e jetës, aty, do të na kalonte duke qëndruar në radhë, pa lëvizur e nganjëherë në shi, në oborre të mërzitshme të Ministrisë së Punëve të Brendshme.

Unë atëherë isha 32 vjeç dhe kisha bërë në Kolumbi një karrierë jetëshkurtër gazetareske; kisha kaluar nja tre vjet shumë të dobishëm dhe të ashpër në Paris, nja tetë muaj në Nju-Jork, dhe doja të bëja skenarë filmash

në Meksiko. Bota e shkrimtarëve meksikanë në atë kohë ishte e ngjashme me atë të Kolumbisë dhe u ndjeva shumë mirë midis tyre. Gjashtë vjet më parë kisha botuar romanin tim të parë “Gjethnaja” dhe kisha tre libra të tjerë gati për botim: “Koloneli nuk ka kujt t’i shkruajë”, që doli më pas në Kolumbi; “Ora e keqe”, që u botua nga Shtëpia Botuese “Era”, pak kohë pas kërkesës së Visente Rojos, dhe vëllimin me tregime “Funeralet e nënëmadhes”. Kësisoj, unë isha një shkrimtar me pesë libra klandestinë, por problemi im nuk ishte ky, sepse, as atëherë e as ndonjëherë tjetër nuk kam shkruar për të qenë i famshëm, por që miqtë e mi të më donin më shumë, gjë që besoja se do ta arrija.

Problemi im i madh si romancier ishte se pas këtyre librave ndihesha sikur të qenësha futur në një rrugicë pa krye dhe po kërkoja me ngulm një shteg për të dalë. Njoha plot autorë të mirë dhe të këqij, të cilët mund të më tregonin rrugën e, megjithatë, ndihesha se po vija vërdallë në rrathët bashkëqendrorë, pa e përfillur lodhjen; përkundrazi, ndieja se ende më mbeteshin mjaft libra pezull, veç nuk po gjeja dot një mënyrë bindëse dhe poetike për t’i shkruar. Isha në këto andralla kur Alvaro Mutis, me hapa të gjatë, ngjiti të shtatë katet e pallatit tim me një pako librash në dorë, prej të cilave nxori librin më të vogël dhe, duke u shkrirë

në gaz, më tha: “Dreqi ta marrë, lexoje këtë mashtrues, nëse do të mësosh!”. Ishte “Pedro Paramo”.

Atë natë nuk vura gjumë në sy, derisa e mbarova së lexuari për të dytën herë; qysh nga nata e tmerrshme kur, nja dhjetë vjet të shkuara, kisha lexuar “Metamorfozën” e Kafkës, në një bujtinë të kobshme studentësh të Bogotës, kurrë nuk kisha përjetuar një tronditje të ngjashme. Të nesërmen lexova vëllimin me tregime Rrafshina në flakë dhe u çmerita njëlloj. Shumë më vonë, në paradhomën e një konsultoreje, në një revistë mjekësore, gjeta tregimin kryevepër të Rulfos, “Trashëgimia e Matilda Arkanhelit”. Pjesën tjetër të atij viti nuk munda të lexoj asnjë autor tjetër, sepse të gjithë më dukeshin kot.

Ende nuk më qe fashitur trandja, kur dikush i tha Karlos Velos* se unë qenësha i aftë t’i recitoja përmendsh paragrafë të tërë nga “Pedro Paramo”. E vërteta ishte edhe më: mund të recitoja komplet librin nga fillimi në fund dhe anasjelltas, pa ndonjë gabim të ndjeshëm, madje, mund të thosha se në cilën faqe të botimit që kisha unë gjendej çdo episod dhe nuk kishte tipar të karakterit të secilit personazh që të mos e njihje në thellësi.

Më vonë, Karlos Vela dhe Karlos Fuentes më ftuan që bashkë me ta të bënim rishikimin kritik të adaptimit të parë të “Pedro Paramos” për film. Kishte dy probleme

të qenësishme: së pari, ishte puna e emrave. Sado subjektive që duket, çdo emër, në një farë mënyre, i ngjan atij që e mban dhe kjo është shumë më e dukshme në fiksim sesa në jetën reale. Huan Rulfo ka thënë, ose ia kanë bërë të thënë, se i vinte emrat e personazheve të tij, duke lexuar gurët e varreve nëpër varrezat e Haliskos; e vetmja gjë që mund të thuhet me siguri, është se nuk ka emra të përveçëm më të veçantë se ata të njerëzve në librat e tij; mua më dukej e pamundur, dhe vazhdon ende të më duket ashtu, se nuk mund të gjeja kurrë një aktor që të identifikoj, pa asnjë mëdyshje, me emrin e personazhit të tij.

E keqja e këtyre shqyrtimeve të këndshme është se kokëfortësitë e frymëzimit nuk janë gjithmonë të njëjtat nga arsyeja. Muajt kur ndodhën disa fakte janë thelbësore për analizën e veprës së Huan Rulfos dhe unë dyshoj nëse ai ka qenë i vetëdijshëm për këtë. Në punën poetike – dhe “Pedro Paramo” është i tillë, në shkallën më të lartë – autorët zakonisht thërrasin muajt për zotime të ndryshme me saktësi kronologjike; edhe më: në plot raste ndryshohet emri i muajit, i ditës, madje edhe i vitit, vetëm e vetëm për t’iu shmangur një rime të papërshtatshme apo dëgjimit të një kakofonie, pa menduar se këto ndryshime mund ta çojnë në një kritikë apo në një ngatërresë përfundimtare. Kjo ndodh jo

vetëm me ditët dhe muajt, por edhe me lulet; ka shkrimtarë që nuk merren me to, me rëndësinë e vërtetë të emrave të tyre, duke mos u thelluar fare nëse përshtaten me vendin apo stinën; kësisoj, nuk është çudi të lexosh libra të mirë ku gjen të lulëzojnë lulemëllaga në rrëzë dhe tulipanë në dëborë. Te “Pedro Paramo”, ku është e pamundur të përcaktosh në mënyrë përfundimtare kufirin midis të vdekurve dhe të gjallëve, përpikëritë janë edhe më kimerike, askush nuk mund të dijë në të vërtetë se sa zgjatin vitet e vdekjes.

I rendita këto pak rreshta, për të thënë, në fund të fundit, se shqyrtimi deri në thellësi i veprës së Huan Rulfos, tek e mbramja, më hapi rrugën për të kërkuar vazhdimin e librave të mi dhe, mu për këtë, e kisha të pamundur të shkruaja për të, pa m’u dukur se e gjitha kjo ishte për mua vetë. Tani po ju them se u ktheva për ta rilexuar edhe një herë gjithë veprën e tij për të shkruar këto shënime të shkurtra nostalgjike, duke u bërë kështu edhe një herë viktimë e pafajshme e së njëjtës çudi, si në rastin e parë; nuk janë më shumë se 300 faqe, por janë, këtë e besoj plotësisht, aq të përjetshme sa ato që njohim nga Sofokliu.

Nëse unë do të kisha shkruar “Pedro Paramon”, nuk do të merrja kurrë guximin të kthehesha e të shkruaja përsëri në jetën time.

/Përktheu: Bajram
KARABOLLI



Veton ZYMBERI, redaktor i sportit

Zidane dhe Pëllumbi përforcojnë Dritën

GJILAN, 5 SHTATOR - FC Drita vazhdon të forcojë radhët e saj për sezonin e ri, duke prezantuar dy prurje të rëndësishme: mesfushorin e ri premtues Mamadou Ben Zidane dhe mbrojtësin shqiptar me përvojë ndërkombëtare, Jorgo Pëllumbi. “Mamadou Ben

Zidane, 19 vjeç, i bashkohet klubit nga skuadra franceze SC Bastia. Mesfushori i ri sjell me vete energji, kreativitet dhe potencial të madh për të ardhmen. Ai pritët të jetë një aset i rëndësishëm për Dritën në garat vendore dhe ndërkombëtare”, thuhet në

njoftimin e Dritës. “Jorgo Pëllumbi, 25 vjeç, është një emër i njohur në futbollin shqiptar dhe më gjerë. Me përvojë në kampionatin shqiptar, kroat dhe hungarez, si dhe me paraqitje për Shqipërinë U21, Pëllumbi është një përforcim i qëlluar për prapavijën e Dritës. Ai njihet për

disiplinën, vendosmërinë dhe qetësinë në lojë”, thuhet në njoftimin e skuadrës nga Gjilani. FC Drita i uron mirëseardhje të përzemërt të dy lojtarëve dhe shumë suksese në këtë kapitull të ri të karrierës së tyre: “Mirë se erdhët në familjen bardhekaltër, Mamadou dhe Jorgo!”.



KOSOVA PËSON HUMBJE TË THELLË NGA ZVICRA

“Epoka e re”

BAZEL, 5 SHTATOR - Përfaqësuesja e Kosovës në futboll ka pësuar një humbje të thellë nga Zvicra me rezultat 4-0, në kuadër të kualifikimeve për Kampionatin Botëror. Ndeshja u zhvillua në stadiumin “St. Jakob-Park” në Bazel dhe u karakterizua nga dominimi i plotë i helvetikëve, sidomos gjatë pjesës së parë. Zvicra e nisi ndeshjen në mënyrë shumë agresive dhe nuk la hapësirë për manovra nga ana e “Dardanëve”. Që në minutat e para, vendasit kontrolluan topin dhe ushtruan presion konstant në gjysmëfushën e Kosovës. Kjo dominancë u shpërblye me katër gola të shënuar vetëm në pjesën e parë. Breel Embolo ishte në formë të lartë, duke realizuar dy herë, ndërsa Manuel Akanji dhe Silvan Widmer shtuan nga një gol secili, duke vulosur një pjesë të parë të shkëlqyer për Zvicrën dhe një mbrëmje zhgënjyese

për Kosovën. Në pjesën e dytë, trajneri i Kosovës, Franco Foda, reagoi me disa ndryshime në formacion. Këto ndërhyrje sollën një përmirësim të dukshëm në lojën e Kosovës, e cila u gjallërua dhe pati disa momente kur arriti të marrë iniciativën. Megjithatë, pavarësisht përpjekjeve dhe disa aksioneve të mira, Kosova nuk arriti të konkretizojë me gol. Mungesa e efikasitetit në fazën sulmuese dhe pasimet jo të sakta në zonën përfundimtare bënë që rezultati të mbetet i pandryshuar deri në fund të takimit 4-0 për Zvicrën. Kjo ishte një humbje e rëndë për “Dardanët”, të cilët kishin shpresuar të marrin një rezultat pozitiv në këtë përballje të vështirë. Pas tre ditësh, Kosova do të ketë rastin të reagojë dhe të kthehet te rezultatet pozitive në ndeshjen që do ta zhvillojë kundër Suedisë, në stadiumin “Fadil Vokrri” në Prishtinë. Kjo përballje pritët të jetë vendimtare për vazhdimin e ëndrrës drejt kualifikimit në



Kampionatin Botëror. Në anën tjetër, Zvicra ka bërë një nisje shumë të mirë në këto kualifikime. Skuadra e drejtuar nga trajneri Murat Yakin tregoi forcë kolektive dhe disiplinë taktike, ndërsa kapiteni Granit Xhaka ishte, si zakonisht, një nga më të dalluarit në fushë me paraqitjen e tij të shkëlqyer.

Kosova U21 barazon me Rumaninë

Kombëtarja e Kosovës U21 e ka filluar me barazim 0-0 fushatën kualifikuese për Kampionatin Evropian. Në lasi u zhvillua një takim i baraspeshuar me të dyja ekipet kombëtare që patën nga 3

goditje në portë. Startues në këtë ballafaqim ishin dy lojtarë nga Superliga e Kosovës, Dijar Vokrri i Ballkanit dhe Arianit Hasani i Llapit, ndërsa nga stoli u aktivizuan Igbal Jashari i Drenicës dhe Erion Sadriu i Ferizajt. Kosova ndeshjen e radhës e luan të martën nga ora 19:00 në “Fadil Vokrri” ndaj Spanjës.

KB PEJA PAS MARRËVESHJES ME BERISHËN, ZYRTARIZON AMERIKANIN JOHNSON



PEJË, 5 SHTATOR - Vetëm një ditë pas rinovimit me kapitenin Dardan Berisha, KB Peja ka bërë një tjetër lëvizje të madhe në tregun e transferimeve duke zyrtarizuar afrimin e amerikanit Jordan Johnson. “KB Peja njofton se ka arritur marrëveshje për transferimin e amerikanit Jordan Johnson (PG, 1.82m, 30 vjeç) për sezonin 2025/26”, thuhet në njoftimin e klubit pejan. Johnson nuk është emër i

panjohur për basketbollin kosovar, pasi gjatë sezonit 2019/20 ka qenë pjesë e elitës në vend, ku ka regjistruar mesatare prej 19.8 pikë, 3.3 kërcime dhe 6.5 asistime për ndeshje. Që atëherë, ai ka ndërtuar një karrierë të pasur ndërkombëtare duke luajtur në Holandë, Ukrainë, Gjermani, Britani të Madhe, Turqi dhe së fundmi në Sllovakia. Në katër sezonet e fundit, Johnson ka mbajtur

mesatare të qëndrueshme, me 15.8, 18.3, 15.6 dhe 13.6 pikë për ndeshje, gjithmonë duke kontribuar edhe me mbi 6 asistime për sfidë. Ai do të ribashkohet në “Karagaçi” me Tajh Green, me të cilin ka luajtur më parë te Newcastle Eagles në Britani. Jordan Johnson ka filluar tashmë stërvitjet nën drejtimin e trajnerit Greg Gibson dhe është gati të japë kontributin e tij për sezonin e ri me ngjyrat verdh e zi.

‘Dardanët’ të hënën mësojnë kundërshtarët në rrugën drejt FIBA EuroBasket 2029

Prishtinë, 5 shtator - Rruga drejt FIBA EuroBasket 2029 do të fillojë në nëntor. Të hënën më 8 shtator nga ora 10:30 do të zhvillohet shorti i Raundit të Parë të Parakualifikimeve të FIBA EuroBasket 2029 në

kryeqytetin letonez, Riga. Ceremonia do të transmetohet drejtpërdrejt në kanalin zyrtar të FIBA-s në YouTube. 10 kombëtare janë të ndara në katër vazo nga FIBA sipas renditjes botërore. Një grup do

të përbëhet nga katër shtete dhe dy grupet e tjera do të përbëhen nga tre shtete. Kosova është në vazon e dytë dhe më 8 shtator do të mësojë kundërshtarët. Raundi i Parë i Parakualifikimeve do të luhet në

tre ditare: nëntor 2025, shkurt 2026 dhe qershor-korrik 2026. Katër kombëtare - tre fitueset e grupeve dhe vendi i dytë më i mirë do të kualifikohen në Raundin e Dytë. Në vazon e parë janë Bullgaria, Maqedonia

e Veriut dhe Sllovakia, kurse në vazon e dytë janë Kosova, Norvegjia dhe Irlanda. Në vazon e tretë bëjnë pjesë Luksemburgu, Armenia dhe Shqipëria. Ndërsa në vazdon e katërt është Azerbajxhani.


Messi për pjesëmarrjen në Kupën e Botës 2026: Ende nuk kam vendosur

BONUES AIRES, 5 SHTATOR - Lionel Messi ende nuk ka vendosur nëse do të marrë pjesë në Kupën e Botës 2026 me Kombëtaren e Argentinës. Sulmuesi argjentinas, i cili shënoi dy gola në fitoren 3-0 ndaj Venezuelës në ndeshjet kualifikuese për Kampionatin Botëror, u shpreh se do të ndjekë ndjenjat e tij për të

marrë një vendim. Ai theksoi se motivimi dhe ndjesia personale janë vendimtare për vazhdimësinë e tij me ekipin kombëtar. “Jam i emocionuar dhe i motivuar për të luajtur. Siç them gjithmonë, eci drejt qëllimit tim ditë pas dite, i udhëhequr nga ndjenjat e mia. Mundohem të ndihem mirë dhe, mbi të gjitha, të jem i

sinqertë me veten time”, ka thënë Messi. “Kur ndihem mirë, e shijoj. Kur nuk ndihem mirë, nuk marr asnjë kënaqësi, kështu që preferoj të mos vij nëse nuk ndihem mirë”. Për sa i përket pjesëmarrjes në Kupën e Botës 2026, Messi u shpreh i rezervuar. “Do ta shohim. Nuk kam marrë ende një vendim në lidhje me Kupën e Botës”, duke

sqaruar se vendimin përfundimtar do ta marrë pas përfundimit të sezonit aktual dhe fazës përgatitore. “Do ta përfundoj këtë sezon, do të kaloj nëpër parasezon. Do të shohim si do të ndihem. Shpresoj ta përfundoj mirë këtë sezon të MLS-së, pastaj të kem një parasezon të mirë dhe vetëm pas kësaj do të marr



vendimin tim”, ka përfunduar ylli argjentinas.

Sylvinho: Kemi bërë një paraqitje të mirë ndaj Gjibraltarit

TIRANË, 5 SHTATOR - Trajneri i Kombëtares shqiptare, Sylvinho, e ka vlerësuar si një paraqitje pozitive atë të ekipit në miqësoren përballë Gjibraltarit. Sipas tij, skuadra bëri mirë dhe me rëndësi ishte fakti që debutuan disa lojtarë të rinj në radhët e kuqezinjve. “Një ndeshje e vështirë. E kam thënë që është gjithmonë e vështirë të përgatitësh një miqësore para një ndeshje të rëndësishme zyrtare siç është Letonia. Është shumë e vështirë. Por ata kanë bërë shumë mirë, 3-4 lojtarë të rinj, që luajnë për herë të parë nga fillimi me ne. Kanë bërë shumë mirë, nuk është e thjeshtë për ta. Mua më kujtohet që në përfaqësuesen e Brazilit, kur debutova, nuk më ka zënë gjumi natën. Jam i lumtur për ta. Edhe për të tjerët. Kemi bërë një paraqitje të mirë, në një ndeshje të vështirë, nuk ishte e



thjeshtë. Kemi bërë diçka të rëndësishme, kemi parë ndonjë lëvizje, por kaq, është gjithçka ende e hapur”, ka thënë Sylvinho për FShf. “Kemi 3-4 ditë stërvitje të mira për të përgatitur shumë mirë një ndeshje shumë të rëndësishme për ne si ajo me Letoninë në shtëpi. Do punojmë në ditët në vijim dhe është çdo gjë e hapur. Kemi bërë 3-4 ditë në këtë

grumbullim, kemi parë se është një ambient shumë i mirë mes nesh. Do kthehemi në Tiranë dhe të presim publikun tonë, që të mund të na japë një shtysë të mirë se është një ndeshje e rëndësishme për ne. Duhet të japim gjithçka në fushë, ajo që duam ne është një atmosferë e mirë mes të gjithë nesh, edhe futbollistëve”, ka shtuar Sylvinho.

Verstappen thumbon Ferrarin: Emri më i madh në F1, por unë garoj për të fituar dhe jo për famë

HASSELT, 5 SHTATOR - Ka pilotë që do të pranonin menjëherë një telefonatë nga Ferrari edhe pa patur një makinë gati për të fituar. Megjithatë, ka nga ata që nuk e shohin tamam në atë mënyrë. Këto janë idetë dhe mendimet e Max Verstappen, i cili nga Monza e kritikon ashpër “kokëkuqen”. “Mendoj se Ferrari është një markë e madhe. Të gjithë pilotët e imagjinojnë veten duke ngarë një makinë të tillë, por mendoj se aty qëndron gabimi. Unë kurrë nuk do të shkoja atje për të ngarë një Ferrari, por sepse do të shihja mundësinë e fitores”, ka thënë Max Verstappen. Kampioni botëror holandez, që garon me Red Bull, ka shtuar më pas: “Mendoj se nuk duhet ta lejojmë veten të ndikohesh nga emocionet dhe pasioni i një marke. Duhet të shkosh atje sepse mendon se është vendi i duhur



për të fituar titullin”. Duke qëndruar te tema e Ferrari, Verstappen komentoi gjithashtu situatën e Leëis Hamilton, në vitin e tij të parë aty. “Nuk di asgjë për atë që po ndodh brenda ekipit ose si po e përballon ai personalisht. Duhet të marrësh në konsideratë që ai po bashkohet me një ekip që tashmë ka një pilot shumë të fortë si Leclerc, i cili është i integruar mirë dhe gjithashtu flet italisht.

Nuk është e lehtë të arrish dhe të mundësh një shok skuadre si ai”. Është thënë shumë për të ardhmen e holandezit. Tani për tani, e vetmja siguri është se ai do të garojë edhe për Red Bull vitin e ardhshëm dhe pastaj do ta shohim, veçanërisht bazuar në rezultatet që ai arrin të arrijë. Emri i Max është lidhur më shumë se një herë me Mercedes dhe Aston Martin.

SHKURT

Rrahmani, lojtar i muajit në ligën elite të Çekisë

Sulmuesi kosovar, Albion Rrahmani, është shpallur futbollisti më i mirë i muajit gusht në elitën e Çekisë. Kjo u bë e ditur të premten në faqen zyrtare të ligës çeke.

Rrahmani ka udhëhequr sulmin e Sparta Pragës gjatë muajit të kaluar, duke shënuar disa gola të rëndësishëm. Në shtatë paraqitjet e fundit për Spartën, në kampionat, sulmuesi i Kosovës, ka realizuar 5 gola, ndërsa kishte shënuar edhe tre gola të tjerë në kualifikime të Ligës së Konferencës. Rrahmani është pjesë e Kosovës për dy duelet ndaj Zvicrës e Suedisë, derisa vjen nga një seri pozitive prej pesë golave në dy ndeshjet e fundit miqësore të “Dardanëve”.

Nagelsmann pas humbjes ndaj Sllovakisë: Duhet të ndryshojmë nëse duam të shkojmë në Botëror

Gjermania ka zhgënjyer në ndeshjen e parë kualifikuese për Botërorin, duke u mundur me rezultatin 2-0 nga Sllovakia. Pas kësaj disfate, trajneri Julian Nagelsmann nuk i kurseu kritikën për paraqitjen e skuadrës së tij. “Kundërshtari ynë ishte thjesht kilometra përpara nesh, nga minuta e parë deri në fund, ky është një fakt. Nuk kemi pasur një histori të shkëlqyer në vitet e fundit, nuk kemi pasur vetëbesim dhe kemi luajtur me 80% të kapacitetit tonë. Nëse duam të shkojmë në Botëror dhe të bëjmë mirë atje, duhet të ndryshojmë këtë”, u shpreh Nagelsmann pas takimit. Humbja ndaj Sllovakisë vjen si një tjetër sinjal alarmi për kombëtaren gjermane, e cila duket larg formës që i ka dhuruar sukseset e së kaluarës.

Trump do të jetë i pranishëm në finalen e ‘US Open’

Presidenti i Shteteve të Bashkuara të Amerikës, Donald Trump, planifikon të marrë pjesë në finalen e meshkujve të turneut US Open, që do të zhvillohet të dielën, raporton “Semafor”, duke cituar burime nga Shtëpia e Bardhë. Presidenti është një tifoz i tenisit dhe ka ndjekur ndeshjet e turneut disa herë. Trump ishte së fundmi i ftuari nderi në finalen e Kupës së Botës për Klube. Presidenti i ShBA-së dhe Zonja e Parë, Melania, morën pjesë në ndeshjen PSG-Chelsea në stadiumin “MetLife në East Rutherford”. Trump u prit me duartrokitje nga turma me të mbërritur në stadium, pak para se të performonin Robbie Williams dhe Laura Pausini. Pas ndeshjes, Trump shkoi në fushë për të vlerësuar lojtarët dhe për të festuar me ta.

Alaba mund të transferohet te Beshiktashi

Qendërmbrojtësi i Real Madridit, David Alaba, mund të jetë pranë një largimi nga “Los Blancos”. Mediat turke dhe ndërkombëtare raportojnë se gjiganti nga Superliga e Turqisë, Beshiktash, është duke punuar

për ta transferuar mbrojtësin austriak, përpara se të mbyllet afati kalimtar më 12 shtator. Alaba, i cili ka vuajtur nga lëndimet në sezonin e kaluar dhe nuk ka pasur shumë hapësirë në formacionin e Carlo

Ancelottit, mund të përfitojë nga një rifillim i karrierës në Stamboll. Beshiktash synon t'i ofrojë një marrëveshje që do t'i garantojë më shumë minuta në fushë – diçka që Alaba e ka pasur të vështirë ta gjejë së

fundmi në “Santiago Bernabeu”. Megjithëse 32-vjeçari ka kontratë me Real Madridin deri në vitin 2026, mungesa e paraqitjeve zyrtare këtë sezon dhe konkurrenca e ashpër në repartin defensiv mund ta

shtyjnë të konsiderojë seriozisht një lëvizje drejt Turqisë. Mbetet të shihet në ditët në vijim nëse Alaba do të pranojë ofertën nga klubi turk, i cili është i vendosur ta bëjë pjesë të skuadrës për sezonin aktual.

Duke u bazuar në Ligjin Nr. 08/L-181 për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, Neni 16, pika 4, Kompania kompanisë “Etri 2” LLC, Skenderaj, në bashkëpunim me Ministrin e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës dhe komunën organizojnë:

DEBAT PUBLIK

Për Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për Pëlqim Mjedisor, – për Zgjerimin e Shfrytëzimit, Thërrmimin dhe Seperimin e Gurit Gëlqeror në Z.K. Qirez, Skenderaj.

Njoftohet publiku i interesuar se më datën 21.10.2025 në ora 10:00 në Objektin e ShMFU “Drenica” Polac, Skenderaj, do të organizohet debat publik nga Kompania kompanisë “Etri 2” LLC, Skenderaj, në bashkëpunim me Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës dhe Komunën.

Debati Publik do të organizohet edhe në mënyrë virtuale në platformën ZOOM

<https://us04web.zoom.us/j/5289487423?pwd=atEPUrNDxCwMcX5GSCHJ57NmAu7JDN.1>

Në linkun e mëposhtëm mund të gjeni raportin e VNM-së për Kompaninë kompanisë “Etri 2” LLC, Skenderaj, për Pëlqim Mjedisor, – për Zgjerimin e Shfrytëzimit, Thërrmimin dhe Seperimin e Gurit Gëlqeror në Z.K. Qirez, Skenderaj.

<https://mmphi.rks-gov.net/Document/Announcements?type=2>

Në emalin e mëposhtëm mund të dërgoni komentet lidhur me projektin

vnm.komente@rks-gov.net

Pjesëmarrja e juaj na ndihmon ne implementimin e projektit.

NJOFTIM

Njoftojmë të gjithë klientët se Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar “The East Group” SH.P.K. me seli në Gjakovë, ka marrë vendim të shuajë biznesin me nrb. 811509712 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditore - Debitorë në këtë korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

OBAVESTENJE

Obavestavanje se svi klienti da drustvo sa “The East Group” D.O.O. Djakovica donelo odluku o prestani rada sa nrb. 811509712 ujedno imenovao Likvidatora o sprovođenju postupka likfidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potrazivanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

ANNOUNCEMENT

We inform al customers that the limited liability “The East Group” L.L.C. with headquarters Gajkovë, has come to the decision to quit its business: 811509712 the company has appointet a liquidator wsho is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgager – mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement- publication.

Thirrje për Aplikim

Kompania: Florina Lladrovci B.I

NUI: 812307214

Adresa: Llapushnik, Rr,Kamer Thaqi nr.7, p.n-Gllogoc

Kërkon ofërtues/kompani të interesuar dhe të kualifikuar që të dorëzoj ofertë për projektin me titull:

Ngritja e serrës së re: me sipërfaqe prej 3600 m², me infrastrukturë përcjellëse.

Investimi përfshinë: *Ndërtimin e serrës se re me sipërfaqe prej 3600 m², me profile të zinguarra komplet, hapje e serres ansore automatike me panel ekelektronik dhe 4 motorr dhe energji solare 7 kw.*

Investimi do të bëhet në adresën: Llapushnik rruga Kamer Thaqi, p.n-Gllogoc

Kompanit e interesuar mund të kontaktojnë nëpermjet email: **florina_lladrovci@gmail.com** apo telefonit **044 816 666** dhe shprehja e interesit të bëhet në adresën e lartë cekur dhe duhet të bëhet me se largu pesë (5) ditë nga data e shpalljes/publikimit. Ndërsa, afati kohor për të dorëzimin e ofertave është të paktën dhjetë (10) ditë, nga data e dergimit të fteses per koutim tek të gjithë ofertuesit/kompanit e interesuara.

Kompanit e interesuar, do të marrin specifikacionin dhe do të ftohen për ofertë financiare.

Kriteret e përzgjedhjes, oferta e përgjegjshme dhe me çmimin me të ulët.

Për çdo sqarim dhe info kontaktoni në numrin:

+383-045-816-666

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- Gadaf Fetahu shpall te pavlefshme dëftesat dhe diplomën QK “11 Marsi” Prizren.

- Halis Ademi shpall te pavlefshme diplomën QK “11 Marsi” Prizren.

- Qendresa Kastrati shpall te pavlefshme dëftesën e kl V- IX shfmu “Brigada 125” Medvec

- Burim Buza shpall të pavlefshme diplomën e gjimnazit “Hajdar Dushi” Gjakovë.

- Lëshoj banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.

- Lëshoj banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.

- Lëshohet banesa me qira ne qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajaziti, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.

- Lëshoj banesën e re me qera në qendër prapa teatrit Kombëtar, me sipërfaqe prej: 60 m2. Banesa ka një dhomë gjumi, sallon dhe kuzhinë. Ka të gjitha pajisjet. Çmimi: 300 €uro. Banesa lëshohet për afate të gjata dhe të shkurtra. Informata në tel: 049\44-888-801 (viber)

- Lëshoj banesë me qira, pent-house. Banesa gjendet te Rrethi i Veternikut në Prishtinë. Banesa ka 150 m2, dhe ka 3 dhoma, dy banjo, 2 garazha si dhe shpajz. Për info mund të na kontaktoni në këtë nume të tel: 049-440-466.

- Lëshoj banesën një dhomshe me qira , ne lagjen Dardania afër Postës Kryesore (posta e Madhe) Kroj i Bardhe, banesa është e mobiluar tërësisht. Për informata lajmërohuni në tel: 044/558-894 Prishtinë.

- Lëshoj me qira banesën e mobiluar te salloni i mobileve "ALBED" në Fushë Kosovë. Banesa i ka 65 metra katrorë dhe është e gatshme për banim. Më shumë informata në: 044/706-079.



ROYAL CROWN

RC
cola

ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

Columbus, Georgia, USA
Since 1904

Columbus, Georgia, USA
0.5L

MEKA
®
HALAL FOOD

TRADITË QË NGA 1992

